

NEW TRENDS IN PICTURE BOOKS OF CHILDREN TENDENCA TË REJA NË LIBRAT ME ILUSTRIME PËR FËMIJË

Emine SHABANI¹

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: emine.shabani@unite.edu.mk

Abstract

In antiquity, the Athenians, and later the Romans, attached great importance to the education of children, both for the art of poetry and the art of oratory. This classical period that spans the last millennium BC, divided into four phases of time, developed children's literature, the most worthy representative of which can be said is Aesop, who wrote the first fables, for children which will later be accompanied by drawings, conform, to the narrative contained in the fable.

Of course, these fables had an educational character, first of all, but also stimulation the creativity, critical thinking, stimulation of imagination, development of emotional intelligence, and abstract thinking in children. Regarding German children's literature, the German writer Goethe says: "Write children's books in such a way that not only children but also adults can read them with pleasure."

Keywords: *Picture books, education, creativity, critical thinking, etc.*

Përmbledhje

Në antikë, athinasit dhe më vonë edhe romakët, i jepnin rëndësi të madhe edukimit të fëmijëve, si për artin e poezisë ashtu edhe për artin e të folurit bukur-oratorinë. Në këtë periudhë klasike që përfshin mijëvjeçarin e fundit para Krishtit, të ndarë në katër faza kohore, u zhvillua edhe letërsia për fëmijë, që përfaqësues më i denjë i saj mund të thuhet është Ezopi, i cili shkroi fabulat e para, për fëmijë të cilat më vonë, edhe do të shoqërohen me vizatime, konform rrëfimit që përmbante fabula.

Natyrisht këto fabula, kishin karakter edukativ para së gjithash por edhe nxitje të kreativitetit, mendimit kritik, nxitje të imagjinatës, zhvillim të inteligjencës emocionale dhe mendimit abstrakt të fëmijët. Për letërsinë për fëmijë shkrimtari gjerman Goethe, thotë: "Shkruani libra për fëmijë, në atë mënyrë që ta lexojnë me kënaqësi jo vetëm fëmijët por edhe të rriturit".

Fjalët kyçe: *Libra me ilustrime, edukim, kreativitet, mendim kritik, etj.*

Hyrje

Në gjysmën e parë të shekullit 20, shkrimtarët Georg Orwell, Aldous Huxley, Evgenij Zamjatin, John London, Margaret Atwood, etj, sikur parashikuan një jetë që po vinte pas një shekulli, ose patën vizionin e qartë, për një të ardhme distopike të shoqërisë njerëzore, e cila do të ishte e përparuar, në aspektin teknologjik, por e varfër në rrafshin shpirtëror, kulturor, e edukativ (sidomos të më të vegjlit), që jo vetëm do t'i dehumanizojë por edhe do t'u hiqte aftësitë e dhuntitë kulturore, përmes një kulture të re...Kjo kulturë e re, vihet re edhe tek librat me ilustrime për fëmijë, në këtë kohë postmoderne.

Duke filluar nga psikologët e psikiatrit: Sigmund Freud, Carl Gustav Jung, Alfred Adler, Jean Piaget, Melanie Klein, Marie Freud, etj, që fëmijës duhet t'i ofrohet një strehë e qetë, ushqim dhe dashuri prindërore, një familje normale, pa dhunë fizike e psikologjike, fëmija nuk duhet dëgjojë, ofendime të ndërsjella në familje, e as të nënvlerësohet dhe mbivlerësohet, etj, por të trajtohet me dashuri familjare dhe edukatë të shëndoshë, që të zhvillohet si personalitet i suksesshëm në të ardhmen. Trajtimi i këtitllë është shumë i rëndësishëm nga mosha 0-5, ose deri 6 vjet në disa raste, pasi që në këtë moshë arrihet pjekuria, ose zhvillimi i inteligjencës emocionale tek ai dhe, kjo është periudha më delikate dhe vendimtare në jetën e njeriut. N.q.s., e kemi trajtuar si duhet një fëmijë gjatë kësaj periudhe tepër të ndjeshme dhe vendimtare për të ardhmen e tij, atëherë kemi krijuar një personalitet të shëndoshë, inteligjent dhe të dobishëm për familjen dhe shoqërinë.

Rezultatet dhe diskutimi

Në jetën e përditshme ndeshemi me njerëz dhe dukuri të ndryshme negative! Por me shpresë, zemërim të drejtë dhe determinim mund ti zgjidhim këto probleme dhe, sfida të përditshme. Për ta gjetur veten në libër, ne duhet të humbasim në libër. N.q.s. librat kanë fuqi ta që ne ta gjejmë veten aty, atëherë librat për fëmijë kanë superfuqi, sepse ne nuk do ta duam një libër njësoj sikurse e kemi dashur kur kemi qenë fëmijë. Shumica prej nesh i mbajmë mend për gjithë jetën librat që i kemi lexuar në fëmijëri, kjo dukuri është dashuri e fuqishme. Leximi është aktivitet kompleks, që e ndriçon trurin tonë në thellësi dhe gjerësi, si asgjë tjetër dhe në aktivitetin fëmijëror, të mbështesim dhe nxisim leximin është aktivitet jetik, që e zhvillon mendimin kritik, imagjinatën dhe inteligjencën emocionale.

Pas ushqimit, strehimit dhe dashurisë, gjëja më me vlerë që duhet t'ua lëmë trashëgim fëmijëve tanë, është leximi-pasioni për libra. Çfarë duam që fëmijët tanë të zbulojnë nëpër libra? Pse lexojmë ne? Për kënaqësi sigurisht! Për edukim, përndritje, etj. Empatia, zhvillon lidhjen dashurore-empati-lidhje. Lexuesit humbasin në libra. Por a mund librat për fëmijë ta shpëtojnë botën-jo, por të rinjtë që i lexojnë ato, munden. Ne kemi nevojë që për qeniet organike/fëmijët, gjërat të zhvillohen natyrshëm. Disa libra janë shkruar për të krijuar konfuzione gjinore te fëmijët. Vendet daltoniste, që duan fëmijët tanë të përfshihen nga marrëzia ashtu sikurse edhe ata. Këto libra janë trushpërlarje për fëmijët.

Kjo dukuri dalëngadalë po merr përmasa, shqetësuese, libra të këtitllë po qarkullojnë, kudo! Personazhet meshkuj në këto libra me ilustrime, si pleqtë ashtu edhe të rinjtë, fëmijët, e foshnjat janë të pikturuara me veshjet ngjyrë roze, në të shumtën e rasteve por edhe të kuqe e ngjyrë vjollce, ngjyrë kjo tipike femërore. Me ngjyrën roze, ata duan të na thonë se nuk është feminine, por mund ta veshin edhe djemtë. Fëmijët indoktrinohen në moshën pesëvjeçare, përpara se ata të mësojnë se çfarë po ndodh me ata dhe jetën e tyre, pasi që këto libra të ilustruara sigurisht që janë për fëmijë të vegjël, parashkollor.

Librat e këtitllë me përmbajtje trushpërlarëse, kanë kohë që po qarkullojnë, në vende të ndryshme të botës, por ka vite që janë të pranishëm e po promovohen edhe te ne, jepen falas, nëpër çerdhe, shkolla etj. Prandaj ne nuk mund ta lëmë mënjatë, këtë dukuri negative që po përhapet, ose si të thuash ta arkivojmë. Ndërgjegjja ime si intelektuale, më urdhëron të ndaj disa shqetësime të rëndësishme lidhur me këtë problem. Apo nuk i vuri në shënjestër të librit të tij *Tradhtia e intelektualëve*, (*The treason of intellectuals*) shkrimtari francez (me origjinë hebreje) Julien Benda, ata intelektualë dhe dijetarë të ndryshëm nga antika e deri në vite e tridhjeta të shek. 20, të cilët kishin bërë revolucione, në art, shkencë, filozofi, etj., por të cilët nuk ishin në koherencë me ndodhitë dhe vlimet politike të kohës së tyre, si të thuash, nuk merreshin me hallet e popullit!

Sot kur po vërshojnë, libra, e filma të ndryshëm (vizatimor, të animuar etj.), me përmbajtje, perverse e perfide për fëmijët, nga mosha 3 deri 5 vjeç e më lartë, që mediumet po bëjnë efektin e tyre më negativ në ndërdijen e të vegjëleve, të cilëve në forma të ndryshme e spontane po tentojnë tua shpërlajnë trurin dhe ti udhëzojnë, çfarë të bëhen e si të bëhen kur të rriten! Këto mënyra fillojnë nga librat me ilustrime, të cilat në brendinë e tyre nuk janë aspak të ngjashëm me librat për fëmijë, para 40, ose 50 vite më parë!

Ata që nga kopertinat kanë vizatime me djem të vegjël, ose heronj të librave, që ngjajnë si vajza, të veshur me ngjyra që janë tipike për femrat, në ato libra, në një faqe të vetme i gjen të gjitha ngjyrat e ylberit dhe për çudi ka elemente, fallike dhe erotike në çdo faqe të këtyre librave, me përmbajtje dhe fjalor për ta dashur, simpatizuar dhe për ti imituar ata. Përse fëmijët e moshave parashkollore? Sepse kjo është mosha e pjekurisë emocionale dhe formimi i personalitetit dhe ajo që lë gjurmë emocionale, shpirtërore në këtë moshë mbetet për gjithë jetën dhe është shumë vështirë, ose e pamundur për tu kthyer në normalitet.

Librat të cilët i kam lexuar dhe analizuar, me përmbajtje të këtyre dhe jo vetëm janë: Bujari dhe shokët e tij, Tregime për mbretin Artur, Tom Gishti, Tregime me vajza që duken si djem, vishen me ngjyra që janë për djem dhe sillen si djem dhe kanë emra vajzash, ose që shoqërohen vetëm me djem dhe nuk duan të shoqërohen me vajza: 365 Përralla për natën e mirë, Rrobat e reja të mbretit, Flauta magjike, Portokaj për të gjithë, Aventurat e Pinokut, Bukuroshja e fjetur, Borëbardha, Kësulëkuqja, Pinoku, Shokët e rinj të Sarës, lapsi ngjyrë rozë i zotit Tinkëlls, Mjekra me miza, Poçi i artë i ylberit, Shamia ngjyrë rozë, Demi blu që quhej Bejb, Doktor Bretku, Kalërimi, Magjia misterioze dhe një numër shumë i madh tregimesh e librash të këtyre.

Nuk e kuptoj përse në moshën tre, pesë, e shtatë vjeçare fëmijët të kenë nevojë të mendojnë për trans gjinorët, orientimet për gjininë e njëjtë dhe se atyre në vend të këtyre librave pa shije, tu ofrohen përralla me përmbajtje edukative, letrare artistike normale, të jetojnë në një botë normale, të lihen të lirë të edukohen nga prindërit e tyre dhe të edukohen e orientohen nëpër institucione, se si të bëhen të dobishëm për familjen dhe shoqërinë, të bëhen, mjekë, inxhinierë, shkencëtarë e shkrimtarë të zotë dhe ta bëjnë botën një vend më të bukur e më të qetë për të jetuar.

Në fillim të viteve të tridhjeta të shekullit të kaluar, Maksim Gorki, ju shkroi letra, kolegëve të tij shkrimtarë në perëndim, ku ndër të tjera u lutej të shkruanin biografi për njerëz të shquar: shkrimtarë, artistë, shkencëtarë, e mjekë, të njohur, sepse në këtë moshë fëmijët ndikohen dhe fascinohen nga arritjet e dijetarëve të ndryshëm dhe duan tu ngjajnë e të bëhen si ata. Një filozof francez në vitin 1988, në veprën e tij *The Undoing of Thought (Zhbërja e mendimit)*, do të shkruajë: "Kur urrejtja ndaj kulturës bëhet vetë pjesë e kulturës, jeta e mendjes humbet çdo kuptim". (Alain Finkielkraut).

Ndërsa filozofi dhe miksi i Goethe-s dhe bashkëthemeluesi i rrymës së romantizmit, Johann Gottfried Herder. "Që nga fillimi, ose për të qenë më të saktë, që nga koha e Platonit e deri në atë të Volterit", shkruan ai, "diversiteti njerëzor kishte dalë përpara gjykatës së vlerave universale", sipas Herderit, "vlerat e përjetshme u dënuan nga gjykata e diversitetit". Filozofi dhe psikanalisti i njohur botëror, Slavoj Žižek, duke bërë analizën e filmave të ndryshëm, atyre me përmbajtje mistike, psikologjike, politike dhe filmave të vizatuar, atyre të animuar, për fëmijë thotë se: "Kinemaja sot është një art ultimativ pervers, ajo nuk ju jep juve atë që dëshironi, ajo ju tregon se si të dëshironi".

Përfundimi

Një prind anonim, u shpreh kështu: "Unë nuk jam kundër-homoseksualëve dhe kundër trans gjinorëve. Ajo që jam unë kundër, është propagandimi i botëkuptimit të tyre ndaj fëmijëve të familjeve tjera. N.q.s. ata janë homoseksualë dhe nuk kanë fëmijë, ata nuk kanë të drejtë t'ua

imponojnë mendimet e tyre fëmijëve tanë, nuk mund ti mësojnë si të mendojnë ata. Unë vet do ta programoj fëmijën tim sipas botëkuptimit tim, sepse unë e ris fëmijën tim, unë paguaj për të, është fëmija im, nuk është as i tyre, as i qeverisë dhe ata nuk kanë të drejtë t'i edukojnë sipas botëkuptimit të tyre se çfarë duhet të bëhen dhe çfarë drejtimi të marrin në jetë.

Përveç librave, janë edhe filmat vizatimorë, ku personazhet meshkuj dhe femra, apo trans gjinorë, kanë mjekra, janë të lyer me buzëkuq dhe me kremra tipike për femra për tu zbukuruar, të veshur me të brendshme femrash fustane, ngjyrë roze, këpucë me taka, me gjeste dhe zë feminine dhe në anën tjetër, bëjnë heroizma e gjeste humane dhe vepra tjera, për të fituar simpatinë e më të vegjëlve. Autorët e këtyre filmave ose veprave të ilustruara, të kthyera në skenarë filmash, e dinë fare mirë se këto skena të çuditshme filmash, do të lënë gjurmë të thella në mendjet dhe zemrat e pa djallëzuara të fëmijëve dhe, do t'i marrin ato si të mirëqena e normale.

Sepse ndërvoja është një sferë e madhe dhe shumë e fuqishme, ajo zë një hapësirë të madhe, në psikikën e njeriut-fëmijës në këtë rast dhe si rrjedhojë ai do ta dojë atë libër dhe film, që e ka lexuar dhe parë në moshën e formimit të inteligjencës emocionale. Sot ne po përpiqemi të përhapim dijen kudo. Kush e di nëse në shekujt e ardhshëm nuk do të ketë universitete për të rivendosur injorancën tonë të dikurshme? Thotë Georg Christoph Lichtenberg (1742-1799). Filozofi francez i shekullit të 19 Charles Renouvier në veprën e tij thotë: “*Bota vuan nga mungesa e besimit për një të vërtetë transcendente*”. Pa një besim të tillë, ne jemi të pafuqishëm kundër grabitjeve të intelektualëve që kanë përqaftuar si të vërtetën e tyre nihilizmin e Kalikleut.

350

Veprat e analizuarra për fëmijë

Bujari dhe shokët e tij, Tregime për mbretin Artur, Tom Gishti, 365 Përralla për natën e mirë, Rrobat e reja të mbretit, Flauta magjike, Portokaj për të gjithë, Aventurat e Pinokut, Bukuroshja e fjetur, Borëbardha, Kësulëkuqja, Pinoku, Shokët e rinj të Sarës, Lapsi ngjyrë rozë i zotit Tinkëlls, Mjekra me miza, Poçi i artë i ylberit, Shamia ngjyrë rozë, Demi blu që quhej Bejb, Doktor Bretku, Kalërimi, Magjia misterioze, etj.

Referencat

- [1]. Alain Finkielkraut, (1988), *The Undoing of Thought*, The Claridge Press, London.
- [2]. Benda, Julien, (1928), *The treason of the intellectuals*, translated by Richard Aldington, was first published in 1928, in London.
- [3]. Charles Renouvier, (Jul 29, 2018), *Philosophie Analytique de l'Histoire: Les Idées. Les Religions. Les Systèmes*, (French Edition).
- [4]. Jung, Carl Gustav, (2010), *Njeriu dhe simbolet e tij*, Fan Noli, Tiranë.
- [5]. Jung, Carl Gustav, (2010), *Ese mbi gjurmimin e pavetëdijes*, Fan Noli, Tiranë.
- [6]. Freud Sigmund (1987), *Pesë leksione mbi psikanalizën* Fan Noli, Tiranë.
- [7]. Adler, Alfred, (2010), *Të kuptosh natyrën e njeriut*, Fan Noli, Tiranë.
- [8]. Slavoj Zizek, (Jan 17, 2006), *The Metastases of Enjoyment: On Women and Causality (Radical Thinkers)*.
- [9]. G.C. Lichtenberg, (2012), *Philosophical Writings, (trans. and ed. by Steven Tester)*, Albany: State University of New York Press.
- [10].

³⁵⁰ Platoni, (1978), Shteti, Rilindja, Prishtinë, f. 201. Shih edhe: Kaliklesi, Në Gjorgias të Platonit, sofisti Kallikles shpreh përbuzjen e tij për përkushtimin e Sokratit ndaj filozofisë: "Ndjehem ndaj filozofëve më shumë si ndaj atyre që përgojnë dhe aktojnë fëmijën". Kaliklesi e tall dhe e kundërshton, Sokratin me idenë e tij se "sa më i fuqishëm, aq më mirë dhe më i fortë" janë thjesht fjalë të ndryshme për të njëjtën gjë. Dhe ai këmbëngul se, "luksi dhe mospërmbajtja janë virtut dhe lumturi, dhe gjithçka tjetër është një xhingël e kotë". Ky është një mendim postmodern i sofistit të njohur në antikë, që e kundërshtonte Sokratin dhe përkushtimin e tij ndaj filozofisë, moralit qytetar dhe përkrahjen e masave popullore.